



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.416/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit L. R., nga S., rruga “...” nr..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndaja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.1 lidhur me nenin 77 par.1 nënpar.1.2 e 1.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës së mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatit Avdi Dinaj, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i krimeve të Rënda, PKR.nr. 60/2023 datë 2 qershor 2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 26 gusht 2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit L. R. për mbrojtjen e ligjshmërisë, kurse anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren PKR.nr. 60/2023 datë 2 qershor 2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.573/2023 datë 20 mars 2024, dhe çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

### A r s y e t i m i

I dënuari L. R. me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i krimeve të Rënda, PKR.nr. 60/2023 datë 2 qershor 2024, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndaja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.1 lidhur me nenin 77 par.1 nënpar.1.2 e 1.5 të KPRK, është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 3.11.2022 deri me 2.06.2023 dhe dënim me gjobë në shumë prej 1200€, kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK me dënim me gjobë në shumë prej 500€. Konform dispozitës së nenit 76 par.1 e 2 nënpar.2.4 të KPRK i është shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1700€ të cilin është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, në të kundërtën i

njëjti do t'i zëvendësohet me burgim (85 ditë), duke ia llogaritur 20€ të gjobë në një ditë burgu. Konform nenit 267 par.5 të KPRK është konfiskuar substanca narkotike e llojit kokainë në peshë të përgjithshme prej 6.62 gram dhe dy peshore digjitale dhe dy aparate për vakumim dhe role najloni, pistoleta me ngjyrë të zezë me mbishkrim ..., pa karikator dhe tre fishekë të kalibrit të panjohur, një karikator me tre fishekë të kalibrit të panjohur dhe kartëmonedhat në vlerë prej 504.60€. Me të njëjtin aktgjykim i dënuari E. Sh. për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPRK është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400€.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.573/2023 datë 20.03.2024, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e prokurorit dhe aktgjykimi i lartcekur është ndryshuar sa i përket vendimit për dënim përkitazi me veprën penale, nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK ashtu që ajo gjykatë të dënuarin L. R. për këtë vepër e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Ankesa e Prokurorit për të dënuarin E. Sh. është refuzuar si e pabazuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit L. R., avokati Avdi Dinaj ( i angazhuar në këtë fazë), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal si dhe shkeljeve të tjera e të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovojë, ashtu që aktgjykimet të ndryshohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo te anulohet aktgjykimi i shkallës së dytë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.237/2024 datë 5.07.2024 ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa, gjeti se:

-kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 ngase nuk janë përpiluar konform dispozitisës së nenit 369 të KPP, për faktin se ju mungojnë arsyet për faktet vendimtare përkitazi me vendimin mbi dënimin, në veçanti aktgjykimet të shkallës së dytë i mungojnë arsyet përkitazi me rritjen e dënimit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartcekura janë të bazuara. Është evidente se në këtë çështje juridiko penale i dënuari e ka pranuar fajësinë, dhe gjykata nuk ka administruara prova në këtë çështje. Mirëpo, për shkak të rëndësisë së vendimit mbi dënimin ligji mbi procedurën penale obligon shprehimisht gjykatën që në arsyetimin e aktgjykimet t'i shtrojë rrethanat që i ka marrë

parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Kështu, sipas dispozitës së nenit 369 par.8 të KPP kur i akuzuari dënohet me burgim, arsytimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë me veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim me të rëndë nga ai i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo heqë dënimin, të shqiptoj dënim alternativ apo ndonjë masë ose të konfiskohet dobia pasurore e fituar me vepër penale.

Kështu, nga arsytimi i aktgjykimit së shkallës së parë del se gjykata me rastin e matjes së dënimit si rrethanë rënduese për të dënuarin L. R. ka vlerësuar faktin se i njëjti me parë ka qenë i dënuar me aktgjykime të plotfuqishme si PKR.nr.86/2016, P.nr.100/2017 dhe P.nr.244/2019, kurse si rrethana lehtësuese faktin se ka pranuar fajësinë, është penduar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla, kushtet familjare pasi që është mbajtës i familjes.

Në ankesën e prokurorit sa i përket vendimit për dënim të paraqitur kundër aktgjykimit të lartcekur theksohet fakti se gjykata e shkallës së parë i ka nënvlerësuar rrethanat rënduese faktin se i dënuari përpos që është recidivist në Kosovë i gjykuar me aktgjykime të plote fuqishme ka ra në kundërshtim me ligjin edhe shtetin e Zvicrës dhe Italisë dhe është dënuar me 3 vite e e tre muaj burgim të cilin fakt prokuroria e ka siguruar nëpërmes ndihmës juridike.

Gjykata e shkallës së dytë duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit e aprovon ankesën e prokurorit dhe ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket vendimit për dënimin me arsytimin se:

“Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënim ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 e 70 të KPK, e duke vlerësuar si rrethanë rënduese se i akuzuari edhe me parë ka qenë i dënuar me aktgjykime të plote fuqishme PKR.nr.86/2016, P.nr.100/2017 dhe P.nr.244/2019. Nga rrethanat lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë, premtimin se nuk do të bie ndesh me ligjin, është mbajtës i vetëm i familjes, andaj në prani të vlerësimit të të gjitha këtyre rrethanave e duke vlerësuar ankesën e prokurorisë, kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se dënimi i shqiptuar me burgim të akuzuarit për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, e posaçërisht duke pas parasysh se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar që rezulton nga aktgjykimet e lartcekura, si dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale dhe shpalljes së intensitetit të kryerjes së të njëjtës, kolegji i Gjykatës së Apelit drejt ka vlerësuar dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim sikur së dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo rezulton edhe nga ankesa e prokurorisë, që ka theksuar se i akuzuari ka qenë recidivist, e cila është konfirmuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, andaj kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar me burgim ndaj të akuzuarit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij”

Mirëpo, nga arsytimi i gjykatës së shkallës së parë nuk del se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta sa i përket të kaluarës kriminale të dënuarit respektivisht recidivizimit, sepse nuk mund të kuptohet se a behet fjalë për recidivizëm special apo të përgjithshëm konform nenit 69 te kodit penal, dhe nuk rezulton se ka vepruar konform dispozitës së nenit 347 të KPP, kurse as prokurori nuk ka paraqitur të dhëna përkitazi me të kaluarën e të dënuarit jashtë Kosove të cilat

me vonë i thekson në ankesë. Kështu, sipas nenit 69 par.4 të KPRK-së është parashikuar se “Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepra penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të gjitha veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur”. Kurse, sipas nenit 347 të KPP - të dhënat penale nga evidenca e të dënuarve, si dhe të dhënat tjera për dënimet për vepra penale mund të lexohen pas përfundimit të procedurës së provave. Kur i akuzuari e pranon fajësinë të gjitha informatat lidhur me dënimet e mëparshme të të akzuarit lexohen para se palët të paraqesin fjalën përfundimtare.

Meqë, këto dispozita nuk janë respektuar nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerëson se arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë nuk kanë mbështetje në shkresë të lëndës, prandaj me të drejtë pretendohet në kërkesë se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase nuk përmbajnë arsye për faktet vendimtare sa i përket vendimit për dënim, të cilat paraqesin bazë që aktgjykimet të anulohen dhe çështja penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet t’i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke siguruar të dhëna të sakta në lidhje me të kaluarën penale të dënuarit, e pastaj të marrë një vendim të drejtë në këtë çështje.

Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Pml.nr.416/2024, me 26 gusht 2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Afrim Shala